

Bashkim Selmani, PhD¹UDC:
349.22(37+4)**ZGJIDHJA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE – KONTRATAT
ROMAKE DHE BASHKËKOHORE TË ADEZIONIT****РЕШАВАЊЕТО НА ПРАВНИТЕ ПРАШАЊА –
РИМСКИ И СОВРЕМЕНИ ДОГОВОРИ НА АДХЕЗИЈА****THE SOLUTION OF THE LEGAL ISSUES – ROMAN AND
CONTEMPORARY CONTRACTS OF ADHESIONS****Abstract**

In the theory and practice of the contracting law, there are known many types of contracts. Among the most important divisions are those with general content and those of adhesion. Contracts of adhesions are among the most controversial contracts in the theoretical studies for the fact that its terms and elements are defined by one party while the other party remains to admit it. Looking at in the prism of the Roman Law, the great English jurists, for example, have not said the right, in the juridical sense *right* as right, but they simply left it *law* as law, because they have been very clear and did not allow that the right, as defined by law, to be equal as a term with the universal right that man has as a human being. Which means that they have been and are closer to the concept *ius* that has been used by *Roman jurisprudence* for the concept of law. Hence with full conviction, we can ask the question: that how much the Albanian state and Albanian jurists rely on Roman law, how do they treat it and how much do they practice it, for example judges, notaries, Albanian bailiffs, on their daily legal issues in the institutions where they work and resolve different legal issues?

Key words: Roman law, Contract, adhesion, law, liabilities, legal system, justice, obligations, contemporary, etc.

¹ Bashkim Dr. Selmani, ligjërues në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Tetovës, Tetovë, 2019.

1. Çfarë bëj unë kur zgjidh një çështje?

Cilat burime të informacionit kërkoj si udhërrëfyes, si ta ndihmoj palën që i përket nacionalitetit tim? Në qoftë se një precedent është i zbatueshëm, kur mund të heq dorë nga zbatimi i tij në rast se është në kundërshtim me interesat nacionale dhe morale? Në qoftë se kërkoj harmoninë logjike dhe simetrinë e strukturës juridike, deri ku duhet ta kërkoj atë? Në ç'pikë do t'i ndal kërkimet për shkak të ndonjë zakoni të kundërt, të arsyeve të mirëqenies shoqërore, të standardeve të mia ose të përgjithshme të drejtësisë dhe moralit? Në këtë përzierje të çuditshme, që zien çdo ditë në kazanin e institucioneve, gjykatave etj. tërë këto elemente përbërëse hyjnë në masa të ndryshme që për çdo ditë kërkojnë zgjidhje të drejtë dhe drejtësi. Termi tagër, i përdorur nga rilindësit për të dhënë në shqip konceptin e së drejtës, që vjen nga ligji, ose nëpërmjet ligjit, ka qenë më i drejtë. Ne këtu nuk po e përmendim si fakt për ta ndërruar termin e drejtë me termin tagër, por vetëm për ta bërë konceptin e së drejtës edhe më të qartë në shpjegimin tonë, dhe për të mos krijuar keqkuptim filozofik për të ndarë konceptin e së drejtës si tagër që vjen nga ligji pozitiv, nga koncepti i drejtësisë ose i së drejtës universale. Hyrë analizës dhe studimit të së drejtës romake është e nevojshme të potencohet së në çdo zgjidhje të çështjeve gjyqësore por, edhe ato juridiko-administrative do të jetë e nevojshme të dallohet e ndërgjegjshmja dhe e pandërgjegjshmja. Rezultantja është një kuptim i jetës, një konceptim i nevojave shoqërore siç ka thënë Xhejmsi, i “shtytjes dhe trysnisë totale të kozmosit” kur arsyet peshohen me kujdes duhet të përcaktojnë zgjidhjen, që do të bëhet. Çdo problem gjen kushtet e zgjidhjes dhe këtyre zgjidhjeve juristët romakë u kushtonin një vëmendje të veçantë duke i trajtuar rast pas rasti dhe në tërësi për të ardhur deri tek një zgjidhje që e kërkonte drejtësia romake. Shikuar nga ky prizëm, përvoja e ligjeve dhe legjislacionit të Maqedonisë dhe ndikimi i juristëve shqiptarë në përgatitjen dhe bërjen e ligjeve kanë shumë pak ndikim për të mbrojtur interesat e përgjithshme shqiptare, jo për shkak shkathtësie dhe përgatitjeve profesionale por nga mosemancipimi për veprim të përbashkët kolektiv. Realisht, juristët shqiptarë dhe të gjithë ne mbajmë një përgjegjësi të kohës që po e jetojmë, sepse të gjitha ligjet për të qenë të suksesshme dhe të barabarta për të gjithë qytetarët, fillimisht duhet lexuar vullneti i ligjbërësit, kjo nuk është e shkruar, këtë vullnet qytetarët nuk kanë sy për ta parë, por, e ndiejnë në padrejtësitë që bëhen në emër të ligjit, dhe të drejtës që realisht për shqiptarët

respektohet i njëjti ligj por, paragrafet, nenet në praktikën juridike edhe rregulloret e disa institucioneve kufizojnë të drejtat e barabarta.

2. Në studimin e së drejtës së krijuar nevojitet një dije më e madhe

Në studimin e së drejtës së krijuar nevojitet një dije më e madhe dhe një bashkëpunim ndërshqiptar për të plotësuar zbrazëtira që duhen mbushur, ka dyshime dhe gabime që duhen sqaruar, ka vështirësi dhe gabime që duhen zbutur, nëse s'mund të mënjanohen. Ky proces zhvillohet herë pas here në drejtësi, prandaj studimi i së drejtës romake do të ndihmojë çdo jurist dhe juristët e ardhshëm që t'i kushtojnë një rëndësi të veçantë këtij studimi civilo-romak, me një logjikë përkujdesjeje dhe preciziteti në studim. Këto dhe shumë pyetje të tjera do t'u japim përgjigjet e fituara nga terreni që do të jenë temë diskutimi në lëndën e së drejtës romake. Gjithmonë në gjuhën juridike apo fjalorin juridik në përditshmëri kur përmendet termi e drejta romake, lë përshtypje të veçantë në atë që çdo njeri dëshiron të trajtohet drejtë nga shteti. Ky term në jetën e përditshme më tepër përkapet si drejtësi e veçantë që në vete ngërthen shtetin Romak dhe institucionet e saj. Për nga definicioni shkencor mund të shprehemi se, termi e Drejta romake, përfshinë të gjithë korpusin juridik dhe institucional të shtetit Romak në të gjithë shtrirjet e saja kohore si mbretëri, republikane dhe perandori, gjithmonë brenda rrjedhës teorike e praktike që përmban e drejta civile *ius civile* edhe e drejta e kombeve *ius gentium*, nuk mund të kuptohet qartë nëse, në trajtimin tonë, nuk do të analizonim kategoritë ku ajo është mbështetur. Ashtu sikundër e drejta juridike e vullnetit të ligjëbërësit. Këtë vullnet duhet ta shohim në juristët dhe ekspertët juridikë për të arritur qytetarët deri tek e drejta dhe drejtësia. Ciceroni për rolin e së drejtës thotë: *Summum jus summa saepe injuria*, e drejta më e madhe ndonjëherë është e padrejtë, më saktë instrument i dhunës klasore.²

3. Sot, në shoqërinë bashkëkohore mund të përpiqemi t'i shohim gjërat me atë objektivitet

Sot, në shoqërinë bashkëkohore mund të përpiqemi t'i shohim gjërat me atë objektivitet që na pëlqen, por kur sot në shoqërinë bashkëkohore mund të përpiqemi t'i shohim gjërat me atë objektivitet

² Bashkim Dr. Selmani, "E drejta Romake dhe ndikimi i saj në sistemet e së drejtës bashkëkohore"-faq. 134-135. Universiteti i Tetovës, 2013.

që na pëlqen, megjithatë ne nuk mund t'i shohim kurrë ato me një tjetër sy, përveç me sytë tanë. Një ankesë ose një akt parlamentar, fajet e të varfërve ose të drejtat e princërve, një urdhëresë politike punësimi ose kushtetuta e një shteti, të gjitha këto shihen pikërisht kështu. Të dhënat nga terreni do të përfshijnë mendimet e ekspertëve shqiptarë si nga Republika e Shqipërisë, Republika e Kosovës dhe Maqedonia, që do të intervistojmë nëpërmjet pyetësorit-anketues shumë ekspertë të kësaj lëmie, gjyqtarë me përvojë shumëvjeçare, juristë, avokatë, prokurorë, noterë, përmbaruesë, studentë etj. Theksuam, vetë kjo e drejtë u rrit në nivel sepse ia arriti që të absorbonte filozofinë greke dhe u zhvillua në relacion me atë filozofi.³

4. Raporti i së drejtës midis personalitetit juridik të individit, familjes dhe pronës

Filozofia greke i dha asaj hapësirën që i duhej për të përdorur logjikën, konceptin dhe idenë brenda suazës së mendjes njerëzore dhe patjetër që, e mbështetur këtu, gjeti rrugën për të krijuar raportin e drejtë midis personalitetit juridik të individit, familjes dhe pronës. Ka një filozofi ku mund të mbështetet çdo qytetërim, dhe sigurisht që kjo vjen patjetër nga filozofia e shtetit. Roma u bë një shtet gjigant, por jo për nga hapësira e pamasë e saj, por nga raportet juridike që u vendosën midis personalitetit shtetëror si entitet juridiko-institucional, dhe individit si pushtet politik, si prijës, lider ose magjistrat, për nga raporti midis personalitetit juridik të qytetarit romak, në lidhje me të drejtat civile që gëzonte, dhe familjes, e pronës së tij private; për nga raporti midis së drejtës kontraktuale si marrëdhënie juridiko-civile dhe së drejtës për të ngritur padi gjyqësore në kërkim të një detyrimi.

5. Konceptit për kapacitetin juridik të personit, i cili, pasi e ka këtë kapacitet për të lidhur një kontratë

Kjo ka qenë arsyeja, që për herë të parë në sensin historik të së drejtës, ne u gjendëm përballë konceptit për kapacitetin juridik të personit, i cili, pasi e ka këtë kapacitet për të lidhur një kontratë, është i detyruar ligjërisht që ta përmbushë atë, ose në të kundërt do të ndeshet përballë një shtrëngimi ose koercioni ligjor që e detyron për ta

³ Po aty.

përmbushur. Domethënë, një raport i drejtpërdrejtë midis kontratës dhe detyrimit ligjor. Personi, sendi dhe detyrimi, janë padyshim tre ingredientët kryesorë ku gjen mbështetjen e vet filozofike e Drejta romake, por duke e shtrirë këtë të drejtë edhe mbi institucionet që vepronin sipas *ius civile* dhe *ius gentium*, arrijmë në konkluzionin se kjo e drejtë e kishte arritur, për herë të parë në histori, rendin juridik universal. Brenda këtij rendi universal, e Drejta romake e konceptoi zhvillimin ekonomik dhe vetë tregun si ligj; si disiplinë ligjore dhe institucionale, dhe kontraktualizmin si marrëdhënie juridike më tepër se 59 marrëdhënie ekonomike, sepse për herë të parë në histori u konceptua kontrata si detyrim ligjor, i mbrojtur në mënyrë specifike nga ligji. E drejta romake me pjesën e saj më të përsosur me obligatat kur bëhet fjalë për disa institucione me të cilat rregullohet qarkullimi juridik midis prodhuesve të pavarur të mallit, ruhet edhe në legjislaturat më moderne. E Drejta romake që nxori terminologjinë moderne, dhe që u bë terminologji e përgjithshme, edhe sot ka për detyrë që juristëve t’u mundësojë të mësojnë gjuhën juridike.⁴ Detyra e mësimit të së Drejtës romake, veçanërisht nevoja që problemet e së Drejtës romake të përpunohen nga aspekti i materializmit historik, imponuan një zgjidhje tjetër, në programin e mësimit të së drejtës romake kombinohen me qëllim elementet e studimit historik dhe sistematik, apo elementet e historisë me elementet e institucioneve të së drejtës romake. Kështu lind shkenca e cila në materialin konkret historik, varësisht prej zhvillimit të marrëdhënieve ekonomiko-shoqërore të Romës, tregon evoluimin e institucioneve juridike. E drejta private, sipas ndarjes së përdorur nga Gaius, përbëhej nga tre pjesë apo korpusë të drejtash, të cilat ishin rregulla mbi subjektet e së drejtës, rregulla mbi pronën dhe rregullat mbi të drejtën procedurale.

6. Kontratat e adezionit në teorinë dhe praktikën e së drejtës kontraktore

Burimet juridike me të cilat rregullohen marrëdhëniet shoqërore ekonomike në vend dhe në planin ndërkombëtar, vështruar edhe nga efektet që sot reflekton ekonomia e tregut dhe globalizimi janë të shumta dhe tepër heterogjene. Këto burime janë formuluar, zyrtarizuar

⁴ E Drejta romake që zhvilloi deri në maksimum teknikën e analizës së fakteve juridike dhe të kualifikimit të marrëdhënieve juridike, akoma mund t’u shërbejë juristëve si një laborator i veçantë shkencor-juridik. Detyra e mësimit të së Drejtës romake.

dhe ratifikuar nga ana e organeve dhe institucioneve të autorizuar në atë mënyrë që të rregullojnë një numër të madh problemesh praktike duke i dhënë rëndësi të veçantë edhe zgjedhjes thelbësore të kontesteve eventuale. Pavarësisht nga rendi dhe sistemi juridik, marrëdhëniet në mes të subjekteve të caktuara në masën më të madhe rregullohen nga kontratat bilaterale ose multilaterale. Numri i kontratave është i madh dhe llojet e tyre në vazhdimësi rriten për shkak të nevojave që kanë subjektet dhe biznesi në përgjithësi. Ndër kontratat tradicionale janë edhe ato të adezionit. Realisht, roli i tyre në praktikë është i madh në kuptim të teknikës së thjeshtë të lidhjes së kontratës dhe efikasitetit për realizimin e nevojave për palët, respektivisht konsumatorët. Mirëpo, në qarqe shkencore vazhdojnë mjaft debate dhe opinione për faktin se vetëm në këtë rast njëra palë i cakton kushtet dhe elementet e kontratës ndërkaq pala tjetër nuk e ka asnjë mundësi tjetër përveç ta pranojë ose jo atë. Superioriteti i njëres palë në raport me palën tjetër e bënë të kontestueshëm parimin e autonomisë dhe barabarësisë së palëve në lidhjen e kontratës. Nëse cenohet ky parim atëherë marrëdhëniet në mes të këtyre palëve a duhet të konsiderohen kontratë?

7. Roli dhe rëndësia e kontratave, posaçërisht në sferën e qarkullimit të mallrave dhe shërbimeve

Si në të kaluarën edhe tani roli dhe rëndësia e kontratave, posaçërisht në sferën e qarkullimit të mallrave dhe shërbimeve, si në të drejtën tonë ashtu edhe në të drejtën krahasimore, është e madhe. Nëpërmjet saj realizohet transferi respektivisht qarkullimi i mallrave brenda vendit dhe në planin ndërkombëtar. Përveç sferës së rregullimit të marrëdhënieve biznesore, me anë të kontratave mund të bartet edhe pronësia. Natyrisht, për shkak të rëndësisë që kanë ato çdo herë duhet të jetë e rregulluar nga sistemi juridik dhe që të prodhojë efekte juridike gjithsesi duhet të jetë në funksion të sistemit juridik. Kontrata ka mision të caktuar në kuadër të marrëdhënieve juridike. Në mënyrë që ky mision të realizohet në mënyrë korrekte atëherë duhet çdo herë të jetë në përputhje të plotë me parimet kushtetuese, dispozita të caktuara ligjore dhe doket e mira biznesore. Kontrata është ligj për palët kontraktuese të cilat për interesin e tyre janë angazhuar dhe kanë përmbyllur ndonjë marrëveshje të caktuar. Kontrata ligjërisht detyruese është shprehje e vullnetit të dy ose më shumë personave që ndërmjet tyre të vendoset një marrëdhënie e caktuar juridike e detyrimeve. Efektet juridike mund të

përbëhen nga themelimi i marrëdhënies ligjërishit detyruese, nga ndryshimi i një marrëdhënieje ekzistuese juridike ose nga suprimimi i saj.

Në teorinë dhe praktikën e së drejtës kontraktore njihen shumë lloje kontratash. Ndër ndarjet më të rëndësishme janë ato me përmbajtje të përgjithshme dhe të adezionit. Kontratat e adezionit janë ndër kontratat me të debatueshme në studimet teorike për faktin se kushtet dhe elementet e saj i përcakton njëra palë ndërkaq palës tjetër i mbetet ta pranojë ose jo atë. Si të tilla, kontratat e adezionit kanë filluar të paraqiten në gjysmën e dytë të shekulli XIX por zhvillimi dhe masiviteti i zbatimit të tyre është shënuar në shekullin XX, duke vazhduar me trend dinamik të rritjes së vazhdueshme. Lindja dhe zhvillimi i këtyre kontratave është një pasqyrim apo refleksion i konceptit të ekonomisë kapitaliste me tendencën e përqendrimit ekonomik dhe rolit dominues të trusteve dhe karteleve si formacione të forta biznesore në sferën e qarkullimit të mallrave dhe shërbimeve. Ky koncept teorik dhe praktik përmbledhet në drejtim të diktimit të kushteve kontraktuale nga njëra palë dhe detyrimin e palës tjetër t'i pranojë ato. Është krejtësisht reale që subjektet biznesore nuk janë të barabarta e rrjedhimisht nuk mund të kenë as pozitë të barabartë juridike. Kontrata e adezionit përveç kriterëve tjera dallohet me superioritetin e njëres palë në kuptim të dominimit të formulimit, sjelljes dhe caktimit të kushteve të kontratës ndaj palës tjetër më të dobët e cila për shkak të nevojave që ka është e detyruar që të pranojë të lidhë një kontratë të tillë.

Kontrata është marrëveshje e cila lidhet ndërmjet dy ose më shumë personave të cilët mbi bazën e autonomisë së vullnetit dhe interesit të caktuar juridik i krijojnë, i ndryshojnë respektivisht modifikojnë ose shuajnë marrëdhëniet e tyre reciproke. Për shkak të rëndësisë që ka ky instrument i komunikimit në mes të palëve, secili vend brenda sistemit juridik e rregullon atë duke i garantuar subjekteve të së drejtës një kornizë të lirive për aktivitete individuale duke u mundësuar atyre që në bazë të iniciativës dhe interesit që kanë t'i rregullojnë marrëdhëniet e tyre juridike. Në bazë të legjislacionit tonë por edhe të vendeve të ndryshme kjo kornizë e lirive kontraktuale për subjektet e interesuara reflektohet në kuptim të bindjes që në mënyrë të pavarur e të lirë por edhe për interesin e caktuar të vendosin se a do të lidhin kontratë apo jo, vullneti që ta zgjedhin subjektin, të caktojnë përmbajtjen e kontratës,

formën e kontratës duke përfshirë edhe caktimin e gjykatës kompetente në rast të kontestit eventual.⁵

Shikuar nga konteksti historik, me herët kontrata nuk është lidhur thjeshtë në bazë të vullnetit (*solo consesus*) dhe që vullneti i thjeshtë i ka detyruar ato (*solo consensus obliguat*). Më vonë afirmohet parimi se kontrata lidhet thjeshtë vetëm në bazë të vullnetit të palëve. Prandaj tani në kushtet e jetës moderne dhe ekonomisë globale, kontrata pa dyshim është akt i rëndësishëm juridik që lidhet me shprehjen e lirë të vullnetit e që për shkak të zhvillimit teknik – teknologjik ka mundësi të behët në forma të ndryshme.⁶

Kontrata është burim material i së drejtës së detyrimeve dhe njëri nga institucionet e rëndësishme të së drejtës civile. Analizuar në aspektin teorik dhe praktik kontratat më të rëndësishme janë ato të cilat krijojnë detyrime. Ky akt është tepër elastik për faktin se me lehtësi individët, subjektet e së drejtës private e publike duke i përfshirë edhe shtetet dhe organizatat ndërkombëtare i rregullojnë marrëdhëniet bilaterale ose multilaterale me një efikasitet të paparë më herët. E drejta kontraktore në substancën e vet bazohet mbi parimin e lirisë kontraktuese dhe të konsensualizmit. Tradicionalisht parimi i lirisë së kontraktimit konstituohet nga liria dhe bindja e vërtetë e palëve që të lidhin kontratën e caktuar. Në parim lejohet iniciativa e palëve që t'i rregullojnë marrëdhëniet e veta por duke i pasur parasysh kornizat të cilat i cakton sistemi juridik i vendit. Sistemi juridik e rregullon lirinë e vendosjes, zgjedhjes së palës, caktimin e përmbajtjes, formën e kontratës, caktimin e gjykatës dhe të drejtën e cila do zbatohet në rast të kontestit eventual. Edhe pse më herët perceptimi me lirinë kontraktuese nuk ka pasur këtë vëllim dhe dimension, e drejta kontraktuale bashkëkohore garanton vullnetin individual i cili duhet të jetë i shprehur seriozisht. Sistemet moderne juridike dallohen pikërisht për faktin se a janë liritë kontraktuale produkt i nevojave shoqërore, a janë ato garantuese të një niveli të lartë marrëdhëniesh shoqërore – ekonomike. Korniza e shprehjes së lirisë së kontraktimit a është cilësore dhe në vëllimin e duhur. Se cila do të jetë liria individuale varet nga baza materiale, politike, filozofike, sociale etj. e shoqërisë së caktuar.

⁵ Bashkim Dr. Selmani, “E drejta Romake dhe ndikimi i saj në sistemet e së drejtës bashkëkohore”-faq. 134-135. Universiteti i Tetovës, 2013.

⁶ Alishani Dr. Alajdin – E drejta e detyrimeve (Pjesa e Përgjithshme) Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik 1985, fq. 190

Është evidente se varësisht nga lloji kontratës, konstatohen dallime në kuptim të kufijve të lirisë së kontraktimit. Nëse analizohet në thellësi kjo çështje del se edhe ligjet, nën ndikimin e rrethanave të caktuara dhe frymës së kërkesave të palëve kontraktuese, nuk kanë mundur që të unifikojnë vëllimin e lirisë kontraktuale. Prandaj, nuk mund të krijohet asnjë perceptim se liria kontraktuale është tërësisht liberale dhe si e tillë mund të ekzistojë jashtë kornizave të një sistemit shoqëror ekonomik modern e të organizuar. Ajo në fakt duhet që të shpreh intencat ekzistuese pozitive të shoqërisë pikërisht aty ku zbatohen dhe realizohen.⁷ Liria e kontraktimit është e ndërlidhur me autonominë e vullnetit të palëve. Çështja e autonomisë së vullnetit të palëve në kuadër të marrëdhënieve kontraktuale ka qenë dhe ende mbetet në sferën e debatit të filozofisë të së drejtës. Një hapësirë domethënëse kësaj autonomie i është dhënë në shoqërinë borgjeze kur në pikëpamje substanciale afirmohet ideja e barazisë dhe e lirisë. Në kapitalizmin liberal afirmohet konkurrenca e lirë e shoqëruar me iniciativat ekonomike tërësisht liberale. Pikërisht, nën ndikimin e kësaj logjike lind autonomia e vullnetit si shprehje ose parimi i vullnetit të palëve, duke ngritur këtë si forcë detyruese edhe mbi ligjin. Prandaj, pala kontraktuese është e lirë që të merr detyrime gjë që nënkupton se fuqia detyruese e kontratës krijohet me vullnetin e palëve e jo me anë të ligjit.⁸ Mund të konstatohet se autonomia e vullnetit në pjesën më të madhe i përshtatet filozofisë individualiste dhe ekonomisë liberale.⁹ Edhe Ligji mbi Marrëdhëniet Detyrimore në vendin tonë, në nenin 2, lidhur me autonominë e vullnetit shprehet se pjesëmarrësit në marrëdhëniet e detyrimeve janë të lirë, që në pajtim me dispozitat urdhëruese, të rendit publik dhe të dokeve të mira, t'i rregullojnë marrëdhëniet e veta sipas vullnetit të tyre. Poashtu pjesëmarrësit mund t'i rregullojnë marrëdhëniet e tyre të detyrimeve ndryshe nga ajo që është paraparë me këtë ligj, përderisa nuk rezulton diçka tjetër nga dispozitat e këtij ligji ose të kuptimit dhe qëllimit të tyre.¹⁰ Në fakt kjo dispozitë juridike në vete përmban qartë edhe mundësinë e kufizimit të lirisë kontraktuale kur konkretisht e në mënyrë shprehimore i detyron palët kontraktore që të veprojnë ose mos të veprojnë në një marrëdhënie kontraktuale. Konsiderojmë se kufizimet

⁷ Po aty, fq. 191

⁸ "Le contra est superie – uer a la loi" Kontrata është mbi ligjin. "Qui dit de contrat dit juste" Kush thotë kontratë thotë drejtshmëri.

⁹ Po aty

¹⁰ Ligji mbi Marrëdhëniet Detyrimore Nr. 04 / L – 077

e tilla janë racionale për shkak se, pavarësisht vullnetit, askush nuk ka të drejtë në të drejta të pakufizuara.

Parimi i konsensualizmit është parim bazë i së drejtës kontraktore. Ky parim konsiston se kontrata mund të lidhet në mënyrë të thjeshtë në bazë të vullnetit të palëve *solo consensus*. Gjithashtu, sipas kësaj për lidhjen e disa kontratave të caktuara është i nevojshëm vetëm vullneti i thjeshtë i palëve dhe nuk është kusht zbatimi i ndonjë forme të caktuar. Kjo nënkupton që pjesëmarrësit në marrëdhënie kontraktuale duhet që vullnetin e tyre ta shprehin me gojë, me shkrim, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë dhe pastaj konsiderohet se kontrata është lidhur. Karakteristikë e konsensualizmit është se kontrata lidhet mbi parimin e mirëbesimit *bona fides*. Parimi *solo consensus obligat* nënkupton se vullneti i thjeshtë detyron gjë që nënkuptohet se ky parim është esencial në kontratën në fjalë. Duke e pasur parasysh numrin e marrëdhënieve kontraktuale që lidhen me *solo consensus*, del se konsensualizmi mbi të gjitha bazohet në vlera morale, nivel të civilizimit dhe vetëdijes juridike të palëve kontraktuale.¹¹

8. Çfarë janë kontrata e adezionit dhe praktika bashkëkohore

Ndarja e kontratave në lloje të ndryshme është e njohur që nga të drejtat klasike. Pasi biznesi bashkëkohor është tepër heterogjen dhe mbi të gjitha masiv kjo ka ndikuar që marrëdhëniet më mes të palëve të interesuara të rregullohen në forma të reja të cilat rrjedhimisht kanë ndikuar që të shtohet numri i kontratave si kreacione të reja të botës moderne që dallojnë dukshëm nga ato tradicionale. Arsye për ndarjen e tyre është identifikimi i tyre në kuptim të marrëdhënieve juridike që i rregullojnë dhe studimit më të lehtë. Duhet vënë në pah se ndarja e kontratave bëhet duke i përdorur termet e llojeve të kontratave, llojeve të kontratave të detyrimeve dhe ndarjen e kontratave të detyrimeve. Po ashtu, dihet se kriteret për ndarjen e tyre nuk janë unike por zakonisht bazohen sipas natyrës së detyrimit, efekteve që prodhon kontrata, formave të kontratës, bazës së kontratës, lëndës së kontratës, përmbajtjes së kontratës, teknikave për lidhjen e kontratës dhe ekzekutimit të kontratës. Njëra ndër ndarjet më të rëndësishme është ai në kontrata me përmbajtje të caktuar dhe të adezionit. Kjo ndarje e trajton kontratën në kuptim të teknikës dhe mënyrës së lidhjes së saj. Andaj, nëse një

¹¹ Dauti Dr. Nerxhivane “Kontratat” Universiteti i Prishtinës – Fakulteti Juridik , Prishtinë 2012, fq.32

kontratë lidhet nga palët të cilët bashkë e përcaktojnë përmbajtjen e saj, atëherë kemi të bëjmë me kontratë me përmbajtje të caktuar. Nëse një kontratë është lidhur në mes të palëve kur njëra palë nuk ka marrë pjesë në përpilimin e saj atëherë kemi kontratë të adezionit.¹² Kontrata e adezionit cilësohet si e tillë për shkak se vetëm njëra palë paraprakisht i cakton elementet dhe kushtet e kontratës ndërsa pala tjetër nuk merr pjesë në përpilimin e kontratës e as që ndikon në ndonjë element të këtyre kontratave. Vënia e komunikimit me palët tjera bëhet nëpërmjet të ofertës ndërkaq pala tjetër vendos se a do ta pranojë ose nuk do ta pranojë ofertën. Pala kontraktuese që dëshiron që t'i lidhë këto kontrata mund ta lidh atë me nënshkrimin e saj ose ta refuzojë lidhjen e saj. Oferta të këto kontrata është specifike meqë është e përgjithshme dhe e përhershme. E përgjithshme konsiderohet ajo ofertë e cila u drejtohet personave të pacaktuar dhe të pakufizuar, gjë që çdo njeri mund t'i lidhë ato nëse konsideron se ka interes juridik. Oferta e cila konsiderohet si kushte të përgjithshme duhet të publikohet paraprakisht në formularë.¹³ Kjo teknikë krijon aso mundësi që këto kontrata të lidhen në numër masiv duke iu referuar lehtësisë së lidhjes së tyre. Duhet potencuar se këto kontrata përveç që dizajnohen në formularë, brenda atyre gjenden edhe kushtet e përgjithshme të biznesit të cilat në detaje i saktësojnë të drejtat dhe detyrimet e palëve kontraktuese në kuptim të respektimit të tyre. Andaj, kushtet e përgjithshme për lidhjen e kësaj kontrate duhet të jenë të vlefshme në mënyrë që ato të prodhojnë efekte juridike. Si të tilla kushtet e përgjithshme të kontratës duhet të jenë në pajtim të plotë me qëllimet e kontratës dhe me doket e mira biznesore.

¹² Ligji mbi Marrëdhëniet Detyrimore!

¹³ Ligji mbi Marrëdhëniet Detyrimore e rregullon me ofertën. Në këtë dispozitë, respektivisht në pikën 1 të saj, oferta konsiderohet propozim për lidhjen e kontratës që i bëhet personit të caktuar dhe përmban të gjitha elementet thelbësore të kontratës, kështu që me pranimin e saj do të mund të lidhë kontrata. Pika 2 e dispozitës përcakton se kontrata konsiderohet e lidhur, nëse palët kontraktuese e lënë për më vonë marrëveshjen për elementet sekondare, me kusht që palët janë pajtuar për elementet thelbësore të kontratës. Nëse palët nuk mund të merren vesh për elementet dytësore, ato do të caktohen nga gjykata duke pasur parasysh negociatat paraprake, praktikën e krijuar ndërmjet kontraktuesve dhe doket. Ndërkaq pika 3, propozimi për lidhjen e kontratës që i bëhet një numri të pacaktuar personash, i cili përmban elementet thelbësore të kontratës, i destinuar për lidhjen e saj, vlen si ofertë, në qoftë se nuk rrjedh ndryshe nga rrethanat e rastit ose doket.

9. Qëndrimet për natyrën juridike të kontratës së adezionit

Opinionet e teoricienëve nuk janë unike me rastin kur debatohet për natyrën juridike të kontratës së adezionit. Ekzistojnë disa grupe teoricienësh që kanë dallime pothuajse substanciale në mes vete për çështjen. Grupi i parë i opinionistëve saktësojnë me bindje se këto kontrata nuk janë fare kontrata ose këto nuk paraqesin grup të veçantë të tyre, por në fakt janë institucione të së drejtës publike siç janë statutet, rregulloret etj., me të cilat rregullohen marrëdhëniet e caktuara juridike. Sipas mendimit të dytë, theksohet se këto kontrata kanë elemente juridike publike dhe juridike civile sepse në vete ato kanë elemente statutare por edhe elemente kontraktuale. Ky grup i teoricienëve ndahet në disa nëngrupe dhe sipas disave theksohet se këto kontrata kanë pjesë statutare dhe me vetëm pak elemente kontraktuale. Të tjerët pohojnë se kontrata e adezionit përbëhet nga elemente statutare dhe kontraktuale, ndërkaq pjesa e tyre statutare është element esencial i saj ndërkaq, pjesa kontraktuale nuk është element esencial.

Një grup tjetër konsiderojnë të kundërtën duke pohuar se pikërisht pjesa kontraktuale është esenciale për kontratën ndërkaq pjesa statutare nuk parqet element esencial. Grupi i tretë i teoricienëve dallon nga të tjetër sepse konsideron se këto kontrata janë krejtësisht të veçanta. Ata mendojnë se për lidhjen e kësaj kontrate palët duhet të merren vesh për elemente esenciale të saj ndërkaq për elemente aksesore pala nuk duhet thënë që të jetë e informuar. Gjatë interpretimit të tyre theksojnë se duhet pasur kujdes që të mos të jenë evidentuar kundërshtime pikërisht kur bëhet fjalë për elemente esenciale të saja për faktin se pikërisht në varësi të këtyre elementeve përcaktohet vlefshmëria e këtyre kontratave. Sipas mendimit të katërt, kontratat adezione janë kontrata të veçanta të së drejtës së detyrimeve për faktin se në vete kanë veçori të caktuara, rregulla specifike e për këtë arsye bëjnë pjesë në grupin e veçantë të kontratave në sferën e qarkullimit të mallrave dhe ofrimit të shërbimeve.¹⁴ Pas analizës së të gjitha elementeve esenciale dhe joesenciale, duke i marrë për bazë dhe konsideruar më kujdesin e duhur mendimet e teoricienëve të caktuar, konsiderojmë se këto kontrata pa dilemë janë kontrata të veçanta për shkak të specifikave që ne i përmendëm më sipër. Mirëpo, lidhur me teknikat e lidhjes së saj, mënyrat e veçanta të interpretimit, posaçërisht çështjes së pabarazisë së palëve, mendojmë se

¹⁴ Alishani Dr. Alajdin “E drejta e detyrimeve (Pjesa e Përgjithshme)” Universiteti i Prishtinës / Fakulteti Juridik 1985 faq. 292–203.

te ky instrument juridik ekziston një linjë tepër e lehtë e cila e ndanë nga ajo që të mos jenë fare marrëdhënie kontraktuale - kontratë. Prandaj ne të radhitemi në anën e teoricienëve që këto kontrata i konsiderojnë të veçanta vetëm për arsyen se është interesi i palës pranuese për cilësitë që ju ofron kjo kontratë në kuptim të shpejtësisë, kursimit të kohës, efikasitetit të punëve, zvogëlimit të shpenzimeve etj. Megjithatë, nuk ka asnjë dilemë se si në asnjë kontratë tjetër nuk ndrydhet më shumë vullneti i palës, nuk cenohen me shumë qëllimet e kontratës dhe pabarazia aq e madhe e palëve konsiderohet e barabartë etj.

Shkenca e së drejtës kontraktore bën dallim në mes të kontratave adezione me ato të ashtuquajtura tip – formularë dhe të faktit. Më sipër u saktësua se te kontrata e adezionit njëra palë i cakton kushtet e lidhjes së kontratës ndërkaq tek kontrata tip ose formular poashtu vetëm njëra palë i cakton kushtet dhe elementet e saj, por në këtë rast pala superiore është ndonjë institucion shtetëror, ndonjë organizatë e specializuar ose profesionale. Dallimi më mes të kontratave të adezionit dhe atyre të faktit është se këto të fundit kanë një teknikë fare të thjeshtë dhe të shpejtë të lidhjes së saj dhe karakterizohen me faktin se oferta dhe pranimi i saj realizohet gati në të njëjtin moment, rasti i blerjes së një bilete në autobus.

10. Rëndësia e kontratave të adezionit

Sipas ligjit kontrata e standardizuar ose tip konsiderohet instrument i komunikimit juridik, respektivisht marrëveshje e lidhur në mes njëres palë, p.sh. shitësit ose ofruesit të shërbimeve në cilësi të formuluesit të kontratës të cilën njëanshëm e formulon me kushte dhe elemente dhe në formë oferte ia ofron palës tjetër që ta pranojë ose jo. Karakteristikë e këtyre kontratave është se ato janë të formuluar në mënyrë identike për një numër të pakufizuar të konsumatorëve. Kontrata mund të përmbajë dispozita, respektivisht akorde të veçanta në mes të shitësit ose ofruesit të shërbimeve dhe konsumatorëve të cilët thirren në kushte të përgjithshme ose standarde të cilat janë përcaktuar paraprakisht nga ana e shitësit respektivisht ofruesit të shërbimeve. Në këtë rast kushtet e përgjithshme ose standardet i detyrojnë konsumatorët respektivisht konsumuesit të cilët i kanë njohur ose është dashur që t'i njohin ato gjatë kohës sa kontrata është në zbatim e sipër. Për shkak se konsumatorët respektivisht konsumuesit janë një pjesë integrale e blerjeve të mallrave pa të cilat nuk mund të jetohet (p.sh. energjia

elektrike, gazi, uji etj.) dhe përdorimit të shërbimeve të ndërlidhura për kryerjen e funksioneve jetike (siç janë ato telefonike, kabllore, bankare, turizmi, shëndetësia, shërbimet komunale etj.) superioriteti i njërës palës është absolut. Ky superioritet i njërës nga palët te kontratat e standardizuara arsyetohet edhe me elemente se ato zbatojnë standarde që janë në dobi të konsumatorit të cilat janë të përcjellura edhe me informata të mjaftueshme.

Për shkak të faktit se konsumatorët edhe në vendin tonë mund dhe ju ekspozohen parregullsisve dhe rreziqeve potenciale që jo rrallë dalin nga lidhja e kësaj kontarte, atëherë institucionet gjyqësore dhe përpiluesit e këtyre duhet që të kenë parasysh se ato me rastin e formulimit duhet që ta transformojnë qasjen tradicionale dhe tani të mbështeten edhe mbi standardet evropiane konkretisht në detyrimin e informimit më të rregullt të konsumatorit në bazë të Direktivës 93/13 EEC. Kjo direktivë ka të bëjë me detyrimin e hartuesit të kontratave tip të cilat në raste të caktuara nuk janë në përputhje me parimin e kujdesit dhe ndershmërisë. Direktiva në fjalë përmban një listë të kushteve që mund të konsiderohen si të padrejta. Lista nuk është mbyllur por ajo plotësohet vazhdimisht duke u bazuar nga rasti në rast në praktikë. Lista aktualisht përbëhet nga 17 kushtet specifike të cilat janë shënuar si dispozita të padrejta.

Kontratat formularë janë të përpiluara në mënyrë mjaft koncize dhe racionale në bazë të përvojës së gjatë të punës së tyre, që afarizmi të kryhet më shpejtë, dhe është me rëndësi se këta formularë i parashohin situatat e shumta të cilat mund të paraqitën nga marrëdhënia juridike me konsumatorët e tyre në përgjithësi. Sipas rregullit nuk lejohet që të behën përjashtime nga këta formularë (më çka nënkuptohet se vërejtjet dhe rezervat e klientëve nuk pranohen). Ka raste të formularëve të caktuar ku është e mundur që klientëve t'u jepet mundësia e orientimit të zgjedhjes së disa varianteve, e që gjithashtu të gjitha dobitë shkojnë në favor të palës së fortë ekonomike. Këto kontrata zakonisht i përdorin bankat, ndërmarrjet hoteliere dhe të udhëtarëve, të transportit etj. Një modealitë specifike parqesin edhe kontratat tip. Kontratat tip janë ato të cilat i rregullojnë marrëdhëniet e ndryshme biznesore në mënyrë "uniforme" të njëjta në ndonjë veprimtari ekonomike. Po ashtu edhe kontrata e faktit karakterizohet për shkak se te këto ka një teknikë fare të thjeshtë dhe të shpejtë të lidhjes së saj dhe karakterizohet me faktin se oferta dhe pranimi i saj realizohet gati në të njëjtin moment.

Conclusion

From this comes that the contract is a legal fact of special importance in different fields or different juridical and economic branches, in the international law, in the family law, in the civil law, in the economic law, etc. The basis of the contract conclusion is to achieve a certain result between the contracting parties which is intended to create, change or wipe off a particular legal relationship. In the legal theory, the contract is defined as a will of consent between two or more parties to which it comes, in order to ascertain, change or terminate any binding legal relationship. This implies the fact that the contract is a result of the will of the contracting parties and that they exclusively define this will and which in the legal science is called *autonomy's principle of the will*. Approval and observance of this principle came to the fore as a result of what the parties in terms of regulating their issues, would much better determine the circumstances and conditions in the contract than the state to interfere with the legal provisions. Among their most important divisions is that of contracts with certain content and adhesion. At the ordinary contract there is the willingness of both parties to enter into a contract. While in the contract of adhesion, this is made in an especial way, when only one party determines the terms and conditions of the contract while the other party does not participate at all but accepts the conditions *en blanc*. In the adhesion contracts, the following characteristics are present: Existence of a superior contracting party in terms of economic strength that may be monopolistic in the market; In the form of a general offer, that proposes the conclusion of contracts to an indefinite and unlimited number of persons; Contractual clauses are an integral part and formulated unilaterally by the party in a stronger business position that the party must accept as they are *en blanc* in whole or completely refuse. Among the most specific forms presented in practice, this contract is the form, from which they are also named as form contracts. These are kind of contracts that are issued by various economic and financial organizations and enterprises that have a large number of clients.¹⁵

¹⁵ It should be noted that all forms of contracts that we have mentioned types, forms, facts and standardized are the result of economic development and the flow of material goods with a speed and rationality significantly greater than in the past. Simply modern economics have replaced the forms of classical contracts with the modern forms. The interfere of state institutions to contribute in remediation of ambiguities,

Recensentë:

Prof. dr. Vllado Kambovski

Prof. dr. Nazmi Maliqi

Bibliografia

1. Bashkim Dr.Selmani „E drejta romake dhe ndikimi i saj në sistemet e së drejtës bashkëkohore”,Tetovë,2013
2. Enkeleda Olldashi “E drejta romake” Botimi i pare, Media print Sh. p. k.
3. Puhan Ivo, “E drejta romake” Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore KSAK-Prishtinë 1980.
4. Arta Mandro “E drejta romake” Tiranë , 2011,
4. Paul Koschaker: Europa und das römische Recht. 4. Auflage. Beck, München 1966,
5. Legier Gerard “E drejta civile DETYRIMET Botimi 19-të Papyrus, Tiranë, 2009
6. Mirjana Polenak –Aqimovska & Vlado Buçkovski “Zgjedhje e teksteve nga e drejta romake” Kumanovë, 2003 “Makedonska riznica” -Kumanovë
7. Paolo Biavati & Michele Angelo & Redi Nazim Shtino “E drejta procesuale Europiane” GER, Tiranë, 2010
8. Bashkim Selmani “E drejta e regjistrimit të patundshëisë” Tetovë, 2011
9. Kadriu Osman “Hyrje në të drejtën civile” - Shkup 2008.
10. Franz Wieacker: Privatrechtsgeschichte der Neuzeit unter besonderer Berücksichtigung der deutschen Entwicklung. 2. Auflage. Vandenhoeck u. Ruprecht, Göttingen 1967,
11. Aliu Dr. Abdulla – E drejta sendore, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik 2004

irregularities, conditional clauses, etc. is almost logical and necessary because it protects the interest of the consumer and other physical and legal entities which are working within the framework of professional correctness.

12. Alishani Dr. Alajdin – E drejta e detyrimeve (Pjesa e Përgjithshme) Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik 1985
13. Dauti Dr. Nerxhivane – Kontratat, Prishtinë 2012
14. Dragasevic Dr. Momir – Novi ugovori u medjunarodnoj poslovnoj praksi, Podgorica 2000
15. Hetemi Dr. Mehdi – E drejta me njohuritë themelore të së drejtës afariste, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik 1986
16. Vasili. Jani – Kontratat civile jo tipike, Tiranë, 2009
17. Ligji mbi marrëdhëniet detyrimore Nr. 04 / L – 077
18. Ligji për mbrojtjen e konsumatorit Nr.
19. Bonfantès Pietro, “Storia del Diritto Romano” (Vol I-II), Societa Editrice Libreria, Milano 1923.